



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit



01- Nr 029/21-4890 dt. 01.02. 2022

Në vështrim të nenit 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, nenit 49 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kryetari i Komunës ne Drenas mori këtë:

V E N D I M


**Për caktimin e komisionit për monitorim, raportim dhe vlerësim të Strategjisë së
Zhvillimit Ekonomik Lokal 2020-2024**

**I. Anëtarët e komisionit për monitorim, raportim dhe vlerësim të Strategjisë së
Zhvillimit Ekonomik Lokal 2020-2024:**

1. Shehrije Mustafa-Kryetare e Komisionit,
2. Besim Tahiraj-Anëtar
3. Besart Bajrami-Anëtar,
4. Adhurim Hoxha-Anëtar,
5. Fitim Veliqi-Anëtar,
6. Agim Kastrati-Anëtar,
7. Albulena Lushtaku-Hetemi-Anëtare,

1. Komisioni punën do ta kryej sipas dispozitave të nenit 16 kapitullit V të udhëzimit administrativ (qrk) Nr.07/2018 për planifikimin dhe hartimin e dokumenteve të Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik lokal 2020-2024 të Komunës së Drenasit dhe Akteve tjera ligjore lidhur me monitorim, raportim dhe vlerësimin e dokumenteve strategjike.

- II.** Komisioni ka për detyrë të bëjë monitorimin e rregullt të zbatimit të dokumenteve strategjike, duke përfshirë detaje rreth monitorimit, raportimit dhe rishikimit të ndërmjetëm, vlerësimit përfundimtarë të zbatimit të dokumentit strategjike si dhe përmbushjen e prioriteteve strategjike komunale.
- III.** Komisioni do bëjë monitorim të vazhdueshëm të zbatimit të dokumentit të miratuar strategjike dhe të ndërmarrë veprime nëse është e nevojshme për të siguruar kryerjen në kohë dhe mënyrën efektive të aktiviteteve të përcaktuara në Planin e Veprimit.
- IV.** Komisioni do të hartoj raport vjetor mbi progresin e zbatimit (raportin e progresit- Raporti i progresit duhet të ofrojë vlerësim të përgjithshëm të zbatimit dhe informata të detajuara lidhur me) të dokumentit strategjike që duhet të përgatitet deri në fund të tremujorit të parë të vitit pasues, dhe raport gjashtë mujor të monitorimit të planit të veprimit.
- V.** Komisioni për punën e vet i raporton Kryetarit të Komunës dhe Ministrisë së Linjës sipas kërkesës.
- VI.** Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi me Nr. 01-Nr 020/04-36685 të datës 03/09/2020
- VII.** Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e Kryetarit të Komunës.


Kryetari i Komunës

Raguz Lladrovci

Iu dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Anëtareve të Komisionit;
- DZHE-s
- Arkivit të Komunës së Drenasit.